


REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E VUSHTRRIË

DATE/A	13.11.2023
PËRMES/PREKO/THROUGH	Kryetari të Komunës z. Ferit Idrizi 
NGA/OD/FROM:	Drejtori i DEBPZHR-së z. Ergin Sungur 
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	THIRRJE PER APLIKIM

Për fermerët e Komunës së Vushtrrisë për pë-fitim në kuadër të implementimit të projektit: "Subvencionimi i prodhimtarisë së qumështit".

I. Qëllimi i thirrjes për aplikim

Qëllimi i thirrjes për aplikim është njoftimi i të gjithë fermerëve – blegtorëve prodhues të qumështit, të Komunës së Vushtrrisë së Komuna e Vushtrrisë-Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të Programit për Zhvillimin e Bujqësisë 2023 do të subvencionojë prodhimtarinë e qumështit për gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 .

II. Mënyra e subvencionimit.

- Subvencionimi do të bëhet për litër të qumështit të dorëzuar në pikë grumbulluese ose në fabrika të përpunimit të qumështit në vlerë prej 0.05€/litër;

- Përfitues do të jenë fermerët prodhues të qumështit sipas standardeve të legjislacionit në fuqi.



III. Kriteret e përcaktuara

- Aplikuesi duhet të jetë banorë i Komunës së Vushtrrisë.
- Të dorëzoj më shumë se 2000 litra qumësht për 6 muajt e parë të vitit 2023.
- Të posedoj kontratë, të vërtetuar nga noteri, për shitjen e qumështit në ndonjërin nga qumështoret e licencuara ose me ndonjërin nga pikat grumbulluese të qumështit të regjistruara si biznes dhe që kanë kontratë me ndonjë nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar) në ndonjërin nga qumështoret e licencuara;
- Të ofroj dëshmi bankare për sasinë mujore të qumështit të shitur (dorëzuar).

IV. Dokumentacioni i nevojshëm:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Vërtetimin nga pika grumbulluese ose qumështorja për sasinë e qumështit të dorëzuar për periudhën Janar- qershor 2023;
3. Kopja e listës së verifikimit të kafshëve të lëshuar nga sektori për identifikim dhe regjistrin në kuadër të AUV;
4. Dëshmia e pagesës nga banka për sasinë e qumështit të shitur (dorëzuar)- pasqyra bankare;
5. Kopja e kontratës, e vërtetuar nga noteri, për furnizim me qumësht, të lëshuar nga qumështoret e licencuara ose pikat grumbulluese të regjistruara si biznese dhe të cilat kanë kontratë me ndonjë qumështorë të licencuar.
6. Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve komunale-mbeturinat.

Kjo thirrje publike është e hapur për aplikim prej datës: 13.11.2023 – 27.11.2023.

Aplikacioni dorëzohet në zyrën e pranimit çdo ditë pune.

Vërejtje: Aplikacionet pas datës 27.11.2023 nuk do mirren parasysh.

